



KDI | INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS

E DREJTA E QYTETARËVE PËR NISMA LEGJISLATIVE

Hyrje

Me 6 tetor të vitit 2011, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Projektligjin për Nismën Legjislative i cili i garanton edhe qytetarëve të drejtën për të ndërmarrë nisma legislative. Nisma legislative nga ana e qytetarëve mund të shprehet ose si një projektligj i draftuar nga ta dhe u kërkohet ligjëvenësve ta miratojnë, ose në formën e një koncepti ligjor, i cili më pas do të zhvillohet nga Kuvendi në bazë të hapave të iniciativës parlamentare të përshkruara më sipër.

Për shkak të rëndësisë që kanë iniciativat legislative nga ana e qytetarëve përmes së cilës mundësohet pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje dhe ndikohet në fuqizimin e demokracisë përfaqësuese në Kosovë, KDI ka filluar implementimin e projektit “Përfshirja e komunitetit lokal në vendimmarrje” projekt ky i mbështetur nga Ambasada Amerikane në Kosovë.

Cila është baza kushtetuese dhe ligjore për nisma legislative në Kosovë? Kush ka të drejtë ta bëjë një gjë të tillë? Sa nënshkrimet të qytetarëve duhen për një nismë legislative në Kosovë? Cilat janë teknikat dhe procedurat për nismat e tilla?, të gjitha këto do të jenë të shtjelluara në këtë doracak –broshurë.

Baza Kushtetuese që garanton të drejtën e qytetarëve për nisma legjislative

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përkatësisht në nenin 79 ka përcaktura se të drejtë për të propozuar ligje kanë:

- Presidenti i Republikës së Kosovës nga fushëveprimtaria e saj/tij,
- Qeveria,
- deputetët e Kuvendit,
- ose më së paku dhjetëmijë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Baza ligjore

Ligji për Nismat Legjislative – qytetarët si iniciues të nismës legjislative

Ligji për Nisma legjislative është miratuar në tetor të vitit 2011 në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Me këtë Ligj janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për propozimin e një projektligji për miratim në Kuvend.

Ky ligj ua njeh të drejtën e nismës legjislative edhe qytetarëve të Kosovës, duke përcaktuar se dhjetëmijë

(10.000) qytetarë mund të marrin një nismë legislative, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Qytetarët mund të marrin nismë legislative për të rregulluar një fushë të caktuar, duke propozuar ligj të ri apo duke propozuar ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese

Ligji për Nisma legislative ka përcaktuar se qytetarët si subjekt të nismës legislative janë të obliguar ta kenë përfaqësuesin e nismës legislative i cili është edhe pika e kontaktit dhe komunikimit me institucionet përkatëse. Po ashtu është e përcaktuar edhe forma e nismës legislative nga qytetarët të cilët kanë të drejtë të nismës për të propozuar ligje duke:

- hartuar projektligjin,
- apo duke i propozuar Kuvendit hartimin e një projektligji të caktuar.

Njoftimi i Kuvendit për fillimin e nismës

Përfaqësuesi i nismës legislative, fillimisht duhet ta procedojë njoftimin për fillimin e nismës e legislative të cilën e dërgon në njësinë përkatëse për Parashtresa dhe Ankesa në Kuvendin e Kosovës. Në kuadër të njoftimit përfshihet edhe informacioni se a do të fillon

nisma legislative për hartimin e një projektligji apo për propozimin e hartimit të një projektligji të caktuar duke dhënë shpjegimet e detajuara në shkresën shpjeguese për objektivat që synojnë t'i realizojnë. Më pas Njësia përkatëse për Parashtresa dhe Ankesa në Kuvend vërteton pranimin e njoftimit për nismën legislative.

Afati kohor për mbledhjen e nënshkrimeve

Që nga momenti i dorëzimit të njoftimit në Kuvendin e Kosovës, organizatorët e nismës kanë në dispozicion afat prej gjashtë (6) muajve për mbledhjen e nënshkrimeve dhe më pas të dërgohet nisma legislative në Kuvendin e Kosovës.

Financimi i nismës legislative

Të gjitha shpenzimet që dalin procesi i nismës legislative (mbledhja e nënshkrimeve, draftimin i nismës etj), mbulohen nga organizatorët apo përfaqësuesi i nismës. Informatat për shumën e shpenzimeve dhe mënyra e financimit bëhen transparente dhe duhet të vihen në dispozicion për Kuvendin e Kosovës.

Lista me nënshkrime nga qytetarët

Lista ku figurojnë nënshkrimet e së paku 10.000 qytetarëve duhet të përfshijë edhe të dhëna tjera si:

- formën e nismës legislative dhe emërtimin e saj;
- emrin dhe mbiemrin;
- numrin personal;
- komunën e lindjes;
- nënshkrimin dhe datën e nënshkrimit.

Verifikimi i listës

Lista e nënshkrimeve të qytetarëve si iniciues të një nisme legislative me qëllim të verifikimit të nënshkrimeve procedohet për në Komisionin Qëndror të Gjydhjeve (KQZ) në afat prej 15 ditëve.

Në rast se KQZ gjatë procesit të verifikimit të listës e vëren ndonjë mangësi eventuale e njofton përfaqësuesin e nismës që në afat kohor jo më shumë se tridhjetë (30) ditë, me qëllim që ta përmirësojë listën e nënshkrimeve. Në rast se KQZ vlerëson se iniciativa është në pajtim me të gjitha kriteret e

përcaktuara në ligj, atëherë brenda tri (3) ditëve e njofton përfaqësuesin e nismës Legjislative për konstatimet e saja.

Procedimi i nismës legjislative në Kuvend

Nisma legjislative e transformuar ose në Projektligj ose në propozim për hartimin e një projektligji të caktuar së bashku me shkresën shpjeguese për objektivat që synojnë t'i realizojnë të nënshkruar nga të paktën dhjetëmijë (10.000) qytetarë i paraqitet Kuvendit nga përfaqësuesi i nismës.

Ceremonia e dorëzimit të nismës legjislative nga përfaqësuesi i saj tek Kryetari apo Kryesia e Kuvendit, bëhet në mënyrë solemne.

Refuzimi i nismës legjislative

Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të nismës ka të drejtë që ta refuzojë nismën legjislative vetëm në rastet kur vlerësohet se nisma: është kundër parimeve themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe nuk i përmban kushtet dhe kriteret e përcaktuar me këtë ligj.

E drejta e ankesës

Në rast se nisma legislative e ndërmarr nga qytetarët do të refuzohet nga njësia përkatëse e Kuvendit me arsyetimin që nisma legislative nuk i përmban kushtet e përcaktuara me këtë ligj, qytetarët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës kompetente për konteste administrative.

Shqyrtimi i Projektligjit

Në rastet kur nisma legislative nga qytetarët është paraqitur në formë të Projektligjit të draftuar, Kuvendi është përgjegjës për shqyrtimin e tij sipas Rregullores së Punës të Kuvendit për Shqyrtimin e Projektligjeve.

Gjatë kësaj faze Kuvendi, Projektligjin ia dërgon Qeverisë për marrjen e opinioneve dhe deklaratave përkatëse. Pas marrjes së opinioneve dhe deklaratave përkatëse nga Qeveria, fillon shqyrtimi i Projektligjit sipas procedurave të përcaktuara me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Përfaqësuesi i nismës legislative ftohet që gjatë gjithë kohës të merr pjesë në punën e komisioneve përkatëse të Kuvendit. Kryesia e Kuvendit mund të lejoj përfaqësuesin të prezantoj nismën në seance plenare ose cakton një deputetë me propozimin e përfaqësuesit që të bëjë prezantimin e nismës në seancë plenare.

Shqyrtimi i propozimit për hartimin e Projektligjit

Në rastin tjetër kur nisma legislative nga qytetaret nuk është në formën e projektligjit të draftuar por në formën e propozimit për hartimin e Projektligjit, Kuvendi është përgjegjës për hartimin e tij konform Rregullores së Punës të Kuvendit për Shqyrtimin e Projektligjeve.

Kuvendi, bazuar në propozimin për hartimin e Projektligjit mund të kërkojë nga Qeveria hartimin e Projektligjit përkatës. Qeveria, cakton njërin nga Ministritë si bartëse për hartimin e Projektligjit. Përfaqësuesi i nismës legislative ftohet që gjatë gjithë kohës të merr pjesë në Grupet Punuese përkatëse.



"Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Institutit Demokratik të Kosovës dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS

Rruga “Bajram Kelmendi” Nr. 38
10 000 Prishtinë,
Republika e Kosovës

+381 38 248 038
info@kdi-kosova.org
www.kdi-kosova.org